



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada - Government

*Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministarstvo Poljoprivrede,
Šumarstva i Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture, Forestry And Rural
Development*

Duke u bazuar në nenin 1.3 pika (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 Mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, dhe nenin 8 paragrafi 15 dhe neni 12 paragrafi 2 pika 5 të Ligjit Nr. 2003/5 për farëra të dt. 15 Prill 2003, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,

Nxjerr sa vijon:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR.13/2008
Për njohjen dhe pranimin e hibrideve të misrit

Neni 1
Qëllimi

1.1 Me këtë udhëzim administrativ përcaktohet mënyra e hulumtimit të hibrideve të misrit në fushat testuese dhe laboratorë, përpunimi statistikorë i të dhënave me qëllim të njohjes dhe pranimin të hibrideve të huaja në Listën e Lejuar të Kosovës.

1.2 Me hulumtimin e hibrideve në fushat testuese dhe laboratorë përcaktohet vlera kultivuese dhe përdoruese e hibrideve siç janë: rendimenti, lagështia e kokrrës, qëndrueshmëria ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve.

Neni 2
Përkufizimet

Termat e përdorura në këtë udhëzim administrativ kanë këto domethënie:

“**autoritet kompetent**” nënkupton Departamentin e Prodhimit dhe Mbrojtjes së Bimëve;
“**inspektor fitosanitar për farë**” nënkupton inspektorin e autorizuar nga ana e autoritetit kompetent për inspektim;

“**institucioni i autorizuar**” nënkupton institucionin e autorizuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;

“**VKP**” nënkupton vlerën kultivuese dhe përdoruese të varieteteve për testim;

“**ISTA**” nënkupton institucionin ndërkombëtar për testimin e farës;

“**OECD**” nënkupton Organizatën për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim.

Neni 3

Kërkesa për testimin e hibrideve të misrit i parashtrohet Seksionit të Farës deri më 1 mars, ndërsa sasia e nevojshme e farës që duhet depozituar në autoritetin kompetent deri me 15 mars.

Neni 4

Hulumtimi i hibrideve të misrit në fushat testuese zgjatë dy 2 vite të cilat kryhen nga institucioni i autorizuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 5

5.1 Për çdo vit të hulumtimit parashtruesi i kërkesës do t'i vë në dispozicion sasi të caktuara të farës në afatin e përcaktuar kohor:

| Grupi FAO-së | Sasia e nevojshme e farës | Afati |
|---------------------|----------------------------------|--------------|
| 200,300,400,500 | 3 kg | |
| 600,700 | 3 kg | 15 mars |

5.2 Fara e hibrideve të misrit duke përfshirë edhe hibridet standarde dorëzohen në organin kompetent në gjendje të pa trajtuar me pesticide. Institucioni i autorizuar për testim është i obliguar të kryej trajtimin e farës dhe hibrideve të misrit me pesticide të njëjta duke përfshirë edhe hibridet standarde.

5.3 Kualiteti i farës duhet ti jetë sipas kushteve të përcaktuara me këtë udhëzim administrativ sa i përket kërkesave bazë për kualitet, paketim dhe deklarim të farës së kulturave bujqësore të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ Nr.04/2003 për Tregtimin e Farës në Kosovë.

Neni 6

Parashtruesi i kërkesës duhet të vejë në dispozicion të dhënat e farës sa i përket: masës së 1000 farave (g), pastërtisë së farës (%) dhe mbirjen e farës (%).

Neni 7

Hulumtimi në fushat testuese

7.1 Hulumtimi i hibrideve të misrit bëhet në fushat testuese të cilat bëhen në rajone me veçori të ndryshme klimatike dhe pedologjike.

7.2 Eksperimentet në fushat testuese vendosen sipas planit më të përshtatshëm eksperimental duke marrë në konsideratë numrin e hibrideve të paraqitura për hulumtime, me qëllim të vlerësimit sa më të mirë të tyre.

Neni 8

Madhësia e ngastrave eksperimentale do të jetë 22.4 m², të cilën e përbëjnë 4 rende me gjatësi 8 m me largësi në mes rendeve 70 cm. Për llogaritje shërbejnë dy rendët e mesit që sipërfaqja llogaritet të jetë 11,2 m². Distanca në mes ngastrave përsëritëse 2m.

Neni 9

Parcelat eksperimentale mbrohen me brezin mbrojtës prej 4 rendesh.

Neni 10

10.1 Gjatë tërë kohës sa zgjatë testimi i një hibridi në fushat testuese dhe në laboratorë krahasimi bëhet me të njëjtin kultivar standard.

10.2 Hibridet standarde të misrit janë hibridet të cilat janë më të njohura në vendin tonë, e të cilat për nga vetitë e tija biologjike dhe ekonomike kanë vlerën më të lartë për qëllimin për të cilën testohen hibridet e rij. Hibridet standarde e përcakton organi kompetent për krahasimin e hibrideve testuese. Hibridet nga ky nen shërbejnë edhe për caktimin e tipit të kokrrës ku mund të jenë: dhëmbaq i fortë dhe gjysme i fortë e hibridet e lajmëruara për testim, nuk guxojnë të ketë lëshime sipas tipit të kokrrës në dem të kualitetit.

Neni 11

Parashtruesi i kërkesës ka të drejtë që gjatë periudhës së vegetacionit t'i vizitoj fushat testuese dhe të informohet për ato, dhe për hibridet standarde.

Neni 12

Vrojtimet gjatë vegetacionit

Gjatë vegetacionit përcaktohen këto të dhëna:

- a) data e mbjelljes, mbirjes; fshisimit - xhufkës dhe shfaqjes së mëndafshit
- b) lartësia e bimës;
- c) lartësia deri tek tramaku parë;
- d) koha e pjekjes.

Neni 13

13.1 Para korrjes së misrit në të gjitha parcelat bëhet numërimi i:

- a) të gjitha bimëve;
- b) bimëve të dështuara;
- c) bimëve të rrezuara dhe
- d) bimëve të thyera.

13.2 Shkallët për vrojtme dhe mënyra e vlerësimit nga paragrafi 1 i këtij udhëzimi administrativ do të përcaktohen me udhëzimin për vrojtme gjatë vegetacionit.

Neni 14

Në të gjitha fushat eksperimentale kryhet mbrojtja nga dëmtuesit dhe barojat e këqija me preparate - pesticide adekuate sipas praktikave prodhuese.

Neni 15

15.1 Me qëllim të përcjelljes së rezistencës respektivisht qëndrueshmërisë së hibrideve të misrit ndaj sëmundjeve më të rëndësishme në Kosovë, në kushtet natyrore të infeksionit gjatë hulumtimit përcillet shfaqja dhe vlerësohet intensiteti i prekjës nga këto sëmundje dhe dëmtues:

- a) njollosja e gjetheve të misrit - *helminthosporium turcicum*;
- b) bloza e misrit - *ustilago maydis*;

- c) kalbëzimi – vyshkja - fusarium sp;
- d) krimbi i misrit -ostrinia nubilalis;

15.2 Nëse vërehet shfaqja e sëmundjeve dhe dëmtuesve tjerë, duhet shënuar kohën e shfaqjes dhe intensitetin e sulmit, e sipas nevojës edhe përqindjen e dëmtimit përkatësisht zvogëlimin e rendimentit të kokrrës.

15.3 Intensiteti i sulmit të sëmundjes vlerësohet nga eksperti i institucionit përgjegjës testues në të gjitha ngastrat eksperimentale.

Neni 16

Korrja e hibrideve të misrit bëhet brenda ditës në të gjitha përsëritjet në fazën e pjekjes fiziologjike të kokrrës së hibridit standard me vegjetacion me të gjatë. Gjatë korrjes caktohet rendimenti dhe lagështia e kokrrës për secilën fushë.

Neni 17

Hulumtimet në laborator

17.1 Për analizat laboratorike merret nga 1 kg kokërr.

17.2 Në analizat e kokrrës caktohen këto parametra si:

- a) materien e thatë;
- b) përbërjen e albuminave;
- c) përmbajtja e vajit;
- d) përmbajtja e hirit;
- e) përmbajtja e celulozës.

17.3 Tek hibridet me shkallë të lartë të lizinës vlerësohet përmbajtja e lizinës, ndërsa tek hibridet amilopektine amidoni.

Neni 18

Analiza Statistikore e Rezultateve të Hulumtimeve Eksperimentale

Për analizën statistikore të rezultateve të fushave eksperimentale përdoret analiza e varijsës dhe testet përkatëse për testimin e varijsës në mes të vlerave mesatare F-testi, t-testi, +me $P=0.05$ dhe $P=0.01$. Të dhënat përpunohen sipas lokaliteteve dhe viteve të hulumtimit, si dhe kalkullohet koeficienti i variacionit.

Neni 19

Përmes analizës së varijsës përpunohen veçoritë: rendimenti i kokrrës kurse veçoritë tjera relevante për njohje tregohen me vlerat mesatare, vargut maksimal – minimal dhe tjera mesatare, varësisht nga natyra e të dhënave në dispozicion.

Neni 20

Rezultatet e hulumtimit

Rezultatet periodike vjetore dhe përfundimtare dy vjeçare të hulumtimit nga fushat testuese dhe laboratorike, varësisht nga lloji i kulturës bujqësore i prezantohen organit kompetent - Seksionit të Farës.

Neni 21
Publikimi

Rezultatet e hulumtimit nga fushat eksperimentale dhe laboratorike publikohen në Gazetën Zyrtare të Kosovës.

Neni 22
Hyrja në fuqi

Ky udhëzim administrativ hynë në fuqi ditën nënshkrimit.

Prishtinë, më 26.03.2008

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministri,
Idriz Vehapi
